



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:276054

Datë: 14.04.2023

Numri i dokumentit: 04191900

PS.nr.10/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti Special, me gjyqtaren Violeta Namani-Hajra, Kryetare e trupit gjykues dhe zyrtarja ligjore Rilinda Kadriu, në çështjen penale kundër të pandehurve B.M për shkak të veprës penale Marrje Ryshfeti nga neni 421 par.2 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK-së, i pandehuri B.B ka kryer veprën penale Ushtrim i Ndikimit nga neni 424 par. 1 të KPRK-së, të pandehurit D.D , S.B, P.K kanë kryer veprën penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 par. 1 KPRK-së, dhe i pandehuri R.Z ka kryer veprën penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 par. 2 KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, PPS.nr.105/22 të dt.22.12.2022, bashkangjitur aktakuzës edhe marrëveshje me pranimin e fajësisë PPS.nr.105/22 datë 16.12.2022, për të pandehurin B.M, dhe marrëveshje me pranimin e fajësisë PPS.nr.105/22 datë 20.12.2022, për të pandehurin B.B, në seancën fillestare, edhe lidhur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë gjatë seancës fillestare, të hapur, verbale të mbajtur me datë 13.03.2023, në praninë e Prokurorit Special, të pandehurve të lartcekur me mbrojtësin e tyre, në bazë të nenit 364 të KPPK-së, gjykata me datë 15.03.2023, publikisht shpalli, dhe me datë 07.04.2023, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurve:

1. B.M, i biri i Xh dhe nënës S, e gjinisë R, i lindur me datë ..., në fshatin ... Komuna ..., tani me vendbanim në rrugën '...', pn. fshatin ..., Komuna e ..., i martuar, baba i dy fëmijëve, me profesion ekonomist, me gjendje të mesme ekonomike, ..., me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në Paraburgim nga data 30.06.2021 deri me datë 30.03.2022.

2. B.B, i biri i A dhe nënës G e gjinisë K, ..., me vendbanim në fshati ..., Komuna e ..., i martuar, ka të kryer fakultetin, me profesion ekonomist, zyrtar në ..., me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në paraburgim nga data 30.06.2022 deri me datë 30.09.2022 .

3. D.D, i biri i P dhe nënës V, e gjinisë K, i lindur me datë ..., në fshatin ..., tani me vendbanim në lagjen ..., në ..., i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, oficer korrektues, pronar në mini fermën '...', me numër persona ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në masën e Arrestit Shtëpiak nga data 30.06.2022 deri me datë 30.07.2022.

4.R.Z, i biri i R dhe nënës Z, e gjinisë O, i lindur me datë ..., në fshati ..., Komuna e ..., ku edhe jeton, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, bujk, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në masën e Arrestit Shtëpiak nga data 30.06.2022 deri me datë 30.07.2022.

5. S.B, i biri i A dhe nënës R e gjinisë S, i lindur me datë ..., në fshatin ... , Komuna ..., ku edhe jeton, i martuar, baba i ... fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, ..., me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në masën e Arrestit Shtëpiak nga data 30.06.2022 deri me datë 30.07.2022.

6. P.K i biri i Z dhe nënës Z, e gjinisë K, i lindur me datë ..., në fshatin N, Komuna e ..., ku edhe jeton, i martuar, baba i ... fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, ..., me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

I. I pandehuri B.M konfom nenit 364 par 1 të KPPRK-së,

ËSHTË FAJTOR

1.

Sepse të pandehurit L.S dhe B.M, në vazhdimësi nga data 01.10.2020 deri me datë 23.02.2021, në Prishtinë, Pejë dhe Istog, të pandehurit L.S, Drejtor i Pagesave Direkte në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, duke vepruar në bashkëkryerje me të pandehurin B.M, Inspektor Regjional në Zyrën Regjionale në Pejë, në cilësinë e personave zyrtar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë pranojnë ryshfet nga të pandehurit G.M, R.Z, A.M, D.D, R.Z, D.D, H.M, H.M, S.B dhe P.K dhe atë si në vijim:

1.1

Nga data 01.10.2020 deri me 15.02.2021, në Pejë dhe Prishtinë, të pandehurit L.S dhe B.M duke vepruar në bashkëkryerje pranojnë ryshfet nga i pandehuri G.M të veprojnë në kundërshtim me detyrën zyrtare, me qëllim që t' ia mundësojnë të përfitojë subvencion në mënyrë të kundërligjshme në vlerë 45,210.00€, në atë mënyrë që, duke e ditur se G.M kishte aplikuar sipas kërkesës nr.21/153671, datë 27.08.2020 për subvencione me të dhëna të pasakta, fillimisht i kërkojnë ryshfet në vlerë 10,000€, por më vonë arrin marrëveshje që vlera e ryshfetit të jetë 8,000€ dhe me datë 03.10.2020 i pandehuri B.M takohet me të pandehurin G.M te pika e derivateve "... " në Pejë dhe pranon ryshfet në vlerë 4,000€, nga kjo shumë 1,000€ i ndal për vete, ndërsa me 05.10.2020 shumë 3,000€ ia dorëzon të pandehurit L.S në Prishtinë, pastaj procedohet Vendimi për pagesë Ref.AZHB.07/4/2-006913/2020, datë 20.10.2020, më tej sipas marrëveshjes kur procedohet Vendimi i dytë Ref.AZHB.07/4/2-002830/2021, i datës 02.02.2021, i pandehuri B.M takohet me të pandehurin G.M në muajin shkurt 2021 afër Stacionit të Autobusëve në Pejë dhe pranon pjesën e dytë të ryshfetit 4,000€, nga kjo shumë për vete i ndal 1,000€, ndërsa pas disa ditësh shumë 3,000€ ia dorëzon të pandehurit L.S në parkingun e ETC-së në hyrje të qytetit të Pejës,-

1.2

Nga data 01.10.2020 deri me 10.02.2021, në Pejë dhe Prishtinë, të pandehurit L.S dhe B.M duke vepruar në bashkëkryerje përmes të pandehurit B.B pranojnë ryshfet nga i pandehuri R.Z që në kundërshtim me detyrën zyrtare t'i mundësojnë të pandehurit R.Z të përfitojë subvencion në mënyrë të kundërligjshme në vlerë 93,400.00€, në atë mënyrë që, derisa i pandehuri R.Z në emër të biznesit "...”me 07.08.2020 aplikon për Bujqësi organike-bimë mjekësore dhe aromatike, të pandehurit L.S dhe B.M duke e ditur se kishte aplikuar për subvencione me disa kultura të cilat nuk subvencionohen sipas programit për vitin 2020, nr.2349/2, datë 19.06.2020, e ftojnë përfaqësuesen e "...”, V.M me datë 12.11.2020 në zyre dhe e njoftojnë se disa kultura nuk subvencionohen, e njëjta me këtë fakt e njofton pronarin R.Z, pastaj i pandehuri B.M dhe L.S përmes të pandehurit B.B arrin marrëveshje me R.Z për shumën e ryshfetit 14,000€ që në mënyrë të kundërligjshme të subvencionohen kulturat e "...”, pastaj i pandehuri S.S gjatë kontrollit administrativë e procedon lëndën pa i plotësuar kriteret e aplikimit dhe në kundërshtim me programit për vitin 2020, nr.2349/2, datë 19.06.2020, tabelën 4 për BMA dhe mbi bazën e kësaj procedohet vendimi ref.AZHB.07/4/2-025416/2020, datë 18.11.2020, në vlerë 44,849.00€, pas kësaj në fillim të muajit dhjetor 2020, i pandehuri R.Z ia dërgon të pandehurit B.B ryshfetin në shumë 7,000€ në Institutin Bujqësorë, pastaj ky i fundit e fton të pandehurin B.M në zyrën e tij, nxjerrë një zarfe me para prej 7,000€, ku prej tyre 5,000€ ia dorëzon B.Mt, ndërsa 2,000€ i ndal për veti, pastaj i pandehuri B.M nga vlera 5,000€, për veti i ndal shumë 1,000€, ndërsa pas disa ditësh shumë prej 4,000€ ia dorëzon të pandehurit L.S në Prishtinë, kurse pjesa e dytë e ryshfetit mbetet pa u dhënë në shumë 7,000€, për shkak të hetimeve është pezulluar Vendimi Ref.AZHB07/4/2-002852/2021, datë 02.02.2021, në vlerë 48,551.00€,-

1.3

Nga data 01.11.2020 deri me 02.02.2021, në Istog dhe Prishtinë, të pandehurit L.S dhe B.M duke vepruar në bashkëkryerje pranojnë ryshfet nga i pandehuri A.M që në kundërshtim me detyrën zyrtare t'ia mundësojnë të përfitojë subvencion në mënyrë të kundërligjshme në vlerë 71,510.00€, në atë mënyrë që, duke e ditur se i pandehuri A.M në emër të biznesit "...”, kishte aplikuar sipas kërkesës nr.10/149864 me 26.08.2020 me të dhëna të pasakta, të pandehurit arrin marrëveshje që të marrin ryshfet 14,000€ në dy pjesë, pastaj pasi zbatohet Vendimi ref.AZHB.07/4/2-002442/2020, dt.19.10.202 në vlerë 35,526.76€, në muajin nëntor 2020, i pandehuri B.M takohet me të pandehurin A.M në fshatin G dhe pranon pjesën e parë të ryshfetit 7,000€, nga kjo shumë 2,000€ i ndal për veti, ndërsa pas disa ditësh shumë 5,000€ ia dorëzon të pandehurit L.S në Prishtinë, ndërsa për pjesën e dytë mbetet pa u dhënë ryshfeti në vlerë 7,000€, sepse për shkak të hetimeve është pezulluar Vendimi ref.AZHB.07/4/2-004715/2021, dt.02.02.2021 në vlerë 35,984.26€,-

1.4

Nga data 01.10.2020 deri me 02.02.2021, në Istog dhe Prishtinë, të pandehurit L.S dhe B.M duke vepruar në bashkëkryerje pranojnë ryshfet nga i pandehuri D.D që në kundërshtim me detyrën zyrtare t'ia mundësojnë të përfitojë subvencion në mënyrë të kundërligjshme në vlerë 58,600.00€, në atë mënyrë që, duke e ditur se i pandehuri D.D kishte aplikuar për subvencione me të dhëna të pasakta, fillimisht i kërkojnë ryshfet në vlerë 10,000€, por më vonë arrin marrëveshjen që vlera e ryshfetit të jetë 5,000€, pastaj procedohet Vendimi Ref.AZHB.07/4/2-006820/2020, i datës 20.10.2020 dhe Vendimi Ref. AZHB07/4/2-018868/2020 i datës

03.11.2020, pastaj sipas marrëveshjes i pandehuri B.M me datë 18.12.2020 takohet me të pandehurin D.D tek market “...” afër stacionit të autobusëve në Pejë dhe pranon ryshfet shumën 2,500€ dhe pas disa ditësh shumën 2,500€ ia dorëzon të pandehurit L.S në kafiteri përballë Gjykatës Kushtetuese në Prishtinë, ndërsa pjesën e dytë të ryshfetit shumën 2,500€ të pandehurit nuk kanë arritur ta pranojnë nga i pandehuri D.D,-

1.5

Nga data 01.10.2020 deri me 02.02.2021, në Pejë dhe Prishtinë, të pandehurit L.S dhe B.M duke vepruar në bashkëkryerje pranojnë ryshfet nga i pandehuri D.D për të kryer veprimin zyrtar që do duhej ta kryenin, kinse do t'i mundësojnë marrjen e subvencionit në vlerë 42,731.00€, në atë mënyrë që, derisa i pandehuri D.D me 26.08.2020 aplikon sipas kërkesës nr.21/153301, mirëpo pas një kohe kontaktohet nga zyrtar të AZHB-së, se dokumentacioni nuk është në rregull dhe mund të futesh në listën e zezë, i pandehuri D.D duke menduar se mund t'i humb subvencionet kontakton me të pandehurin B.M dhe në bashkëpunim me të pandehurin L.S i kërkojnë ryshfet 3,600€, pastaj me datë 03.10.2020, i pandehuri B.M takohet me të pandehurin D.D në fshatin R tek market “...” dhe merr ryshfet pjesën e parë në vlerë 2,000€, dhe të njëjtat me datë 05.10.2020 ia dorëzon të pandehurit L.S në vlerë 2,000€, në zyrën e tij në objektin e AZHB-së në Prishtinë, pastaj procedohet për pagesë Vendimi ref.AZHB.07/04/2-0069802020, i datës 20.10.2020, ndërsa kur procedohet Vendimi ref.AZHB.07/4/2-002826/2021, dt.02.02.2021 për pjesën e dytë, i pandehuri B.M në fillim të muajit shkurt 2021 takohet me të pandehurin D.D në rrugën transit për P te marketi “...” dhe merr ryshfet 1,600€, pastaj shumën 600€ i ndalë për vete, ndërsa pas disa ditësh shumën 1,000€ ia dorëzon të pandehurit L.S në Prishtinë në kafiterit afër Gjykatës Kushtetuese,-

1.6

Nga data 01.11.2020 deri me 10.02.2021, në Pejë dhe Prishtinë, të pandehurit L.S dhe B.M duke vepruar në bashkëkryerje pranojnë ryshfet nga i pandehuri R.Z të veprojnë në kundërshtim me detyrat zyrtare duke ia mundësuar të pandehurit R.Z të përfitojë subvencion në mënyrë të kundërligjshme në vlerë 12,000.00€, në atë mënyrë që, paraprakisht i pandehuri B.M dhe R.Z pajtohen që duke përdorur të dhënat e personit A.Z me datë 24.08.2020 aplikojnë për blegtori duke paraqitur rrejshëm gjendjen faktike dhe në bazë të këtij deklarimi procedohet Vendimi ref.AZHB.07/4/2-027435/2020, dt.23.11.2020, në vlerë 8,000.00€, menjëherë kur bëhet pagesa, në nëntor 2020 i pandehuri B.M takohet me të pandehurin R.Z në fshatin Novosellë dhe pranon ryshfet në vlerë 3,000€, nga kjo shumë 1,000€, i ndal për veti, ndërsa shumën 2,000€ ia dorëzon të pandehurit L.S në kafiterin “...” afër objektit të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë në Prishtinë, pastaj sipas marrëveshjes më vonë procedohet për pagesë edhe Vendimi ref.AZHB.07/4/2-004798/2021, dt.02.02.2021, me vlerë 4,000.00€,-

1.7

Nga data 01.11.2020 deri me 04.02.2021, në I dhe P, të pandehurit L.S dhe B.M duke vepruar në bashkëkryerje pranojnë ryshfet nga i pandehuri H.M që të veprojnë në kundërshtim me detyrat zyrtare duke ia mundësuar të pandehurit H.M të përfitojë subvencion në mënyrë të kundërligjshme në vlerë 13,157.00€, në atë mënyrë që, duke e ditur se H.M kishte aplikuar për subvencione me të dhëna të pasakta duke përdorur pronën publike, fillimisht i kërkojnë ryshfet

në vlerë 6,000€ për mos ta vendosur në listën e zezë, mirëpo më vonë arrijnë marrëveshje për vlerën e ryshfetit 4,000€, pastaj procedohen për pagesë Vendimi Ref.AZHB.07/4/2-016281/2020, i datës 27.10.2020, dhe sipas marrëveshjes i pandehuri B.M takohet me të pandehurin H.M në një kafiteri në fshatin G, komuna I dhe pranon ryshfet në vlerë 2,000€, pastaj i pandehuri B.M në bazë të video incizimit me datë 04.02.2021 në ora 13:38, ia dorëzon të pandehurit L.S ryshfetin në vlerë 2,000€ në zyrën e tij në objektin e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, pastaj më vonë procedohet për pagesë edhe Vendimi Ref.AZHB.07/4/2-004739/2021, të datës 02.02.2021 dhe i pandehuri H.M e pranon subvencionin, mirëpo ryshfetin për pjesën e dytë në vlerë 2,000€ nuk mund ta marrin të pandehurit,-

1.8

Nga data 01.11.2020 deri me 02.02.2021, në P dhe P, të pandehurit L.S dhe B.M duke vepruar në bashkëkryerje pranojnë ryshfet nga i pandehuri H.M për të kryer veprimin zyrtar që do duhej ta kryenin, kinse do t'i mundësojnë marrjen e subvencionit në vlerë prej 18,209.00€, në atë mënyre që, pasi i pandehuri H.M me datë 25.08.2020 aplikon sipas kërkesës nr.21/152506, pas një kohe kontaktohet nga zyrtar të AZHB-së se dokumentacioni nuk është në rregull dhe mund të futet në listën e zezë, pastaj i pandehuri H.M duke menduar se mund t'i humb subvencionet takohet me të pandehurin B.M dhe në bashkëpunim me të pandehurin L.S arrin marrëveshje për vlerën e ryshfetit 1,500€ t'ia mundësojnë marrjen e subvencionit, pastaj procedohet për pagesë Vendimi ref.AZHB.07/04/2-018750/2020, datë 02.11.2020, sipas marrëveshjes në muajin nëntor 2020 i pandehuri B.M takohet me të pandehurin H.M në shtëpinë e tij në fshatin L dhe pranon ryshfet në vlerë 1,500€, ku për vete i ndal shumë 500€, ndërsa pas disa ditësh shumë 1,000€ ia dorëzon të pandehurit L.S në Prishtinë, pastaj më vonë procedohet për pagesë edhe Vendimi ref. AZHB.07/04/2-0027592021, datë 02.02.2021, -

1.9

Me datë 13.12.2020, në ora 11:00, në restorantin te pika e derivateve "...” në Veternik në Prishtinë, të pandehurit L.S dhe B.M, duke vepruar në bashkëkryerje pranojnë ryshfet nga i pandehuri S.B për të kryer veprimin zyrtar që do duhej ta kryenin, kinse do t'i ndihmojnë të përfitojë subvencion 22,666.60€, në atë mënyrë që derisa i pandehuri S.B aplikon sipas kërkesës nr.21/153627 datë 27.08.2020, pas një kohe kontaktohet nga zyrtar të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë se dokumentacioni nuk është në rregull dhe mund të futet në listën e zezë, pastaj i pandehuri S.B duke menduar se mund t'i humb subvencionet kontakton me të pandehurin B.M dhe në bashkëpunim me të pandehurin L.S i kërkohen ryshfet në vlerë 1,600€, në këmbim të nxjerrjes së Vendimit të kundërligjshme Ref.AZHB.07/4-2-027177/2020, datë 23.11.2020, në vlerë 11,543.30€, pastaj sipas marrëveshjes i pandehuri S.B dhe i pandehurin B.M takohen në Pejë dhe me veturën e të pandehurit S.B vijnë në Prishtinë dhe takohen me të pandehurin L.S me datë 13.12.2020, në ora 11:00, në restorant te pika e derivateve "...” në Veternik dhe në këtë takim i pandehuri B.M pranon ryshfet shumë 1,600€, ku prej tyre 300€ i ndal për veti, ndërsa të pandehurit L.S ia dorëzon shumë 1,300€ në veturën e tij në prani të të pandehurit S.B, pastaj më vonë sipas marrëveshjes procedohet për pagesë edhe Vendimi Ref.AZHB.07/4-2-002769/2020, datë 02.02.2021, në vlerë 11,123.30€,-

1.10

Nga data 01.11.2020 deri me 02.02.2021, në Pejë dhe Prishtinë, të pandehurit L.S dhe B.M duke vepruar në bashkëkryerje pranojnë ryshfet nga A.A (tani i ndjerë) që të veprojnë në kundërshtim me detyrën zyrtare duke ia mundësuar të përfitojë subvencion në mënyrë të kundërligjshme, në atë mënyrë që, duke e ditur se A.A gjatë aplikimit në emër të tij dhe me të dhëna të A.A kishte aplikuar për subvencione me datë 26.08.2020 sipas kërkesës nr.10/153118 me të dhëna të pasakta, i kërkojnë ryshfet në vlerë 2,000€ për mos ta vendosur në listën e zezë, pastaj procedohet Vendimi ref.AZHB.07/4/2-024576/2020, datë 14.11.2020 dhe Vendimi Ref.AZHB.07/4/2-028974/2020, datë 02.12.2020, sipas marrëveshjes në muajin nëntor 2020 i pandehuri B.M takohet me A.A në V te shtëpia e tij dhe pranon ryshfet në vlerë 1,000€, pastaj pas disa ditësh i takon të pandehurin L.S në Prishtinë, në kafiterin përballë Gjykatës Kushtetuese dhe ia dorëzon ryshfetin në shumë 1,000€, ndërsa për pjesën e dytë B.M takohet me A.A në afërsi të marketit “...” në hyrje të Pejës, pranon ryshfet shumën 500€,-

1.11

Në muajin dhjetor 2020, në Pejë dhe Prishtinë, të pandehurit L.S dhe B.M duke vepruar në bashkëkryerje pranojnë ryshfet nga i pandehuri P.K që të veprojnë në kundërshtim me detyrën zyrtare duke ia mundësuar të përfitojë subvencion, në atë mënyrë që, duke e ditur se P.K kishte aplikuar me të dhënat e birit të tij L.K sipas kërkesës nr.21/132676 të datës 27.08.2020, por nuk i plotësonte kushtet për subvencion, atëherë me datë 08.10.2020 vendoset në listën e zezë, mirëpo i pandehuri B.M takohet me të pandehurin P.K në restaurant “...” në dalje të Pejës dhe pranon ryshfetin në shumën 400€, pastaj me datë 13.12.2020 këto para ia dorëzon të pandehurit L.S, në ora 11:00, në restaurant te pika e derivateve “...” në Veternik në Prishtinë, ndërsa me datë 15.12.2020 hiqet nga lista e zezë në mënyrë të kundërligjshme nga i pandehuri B.N,-

- Me këtë ka kryer veprën penale Marrje ryshfeti nga neni 421 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 në bashkëkryerje dhe nenin 77 vepra penale në vazhdim, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata me aplikimin e neneve 7,17, 38, 39,40, 42, 59, 62, 69, 70, 79, 421 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 në bashkëkryerje dhe nenin 77 të KPRK-së dhe nenit 364, 449, 450 dhe 452 të KPPRK-së, të pandehurin e :

G J Y K O N

Të pandehurin B.M i shqipton, **Denim me Burgim** në kohëzgjatje prej 1 viti, e 6 gjatë muaj, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim që nga data 30.06.2021 deri me datë 30.03.2022, i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Ne vështrim të nenit 59 par 2 nën par 2.2, nën par 2.3 të KRPK-së, të pandehurit i cakton;

DËNIMIN PLOTËSUES

Në mbështetje të nenit 61 par 1 të KRPK-së, obligohet i pandehuri B.M që të bëjë kompensimin e dëmit të shkaktuar buxhetit të Republikës së Kosovës në vlerë 8,400.00€.

Në mbështetje të nenit 62 par 3 të KRPK-së, të pandehurit B.M t'i **NDALOHET** për tri (3) vite ushtrimi i funksionit në administratë publike apo funksioneve në shërbime publike pas mbajtjes së dënimit me burgim.

Obligohet i pandehuri i lartcekur që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej dyqind **(100) €**, ndërsa shumën prej njëqind **(100) €**, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. I pandehuri B.B, konfom nenit 364 par 1 të KPPRK-së,

ËSHTË FAJTOR

I pandehuri B.B , nga data 07.10.2020 deri me datë 02.02.2021, në Institutin Bujqësorë, në Pejë, në mënyrë të drejtpërdrejtë pranon përfitim pasuror nga i pandehuri R.Z të ushtrojë ndikim të padrejtë te të pandehurit B.M, L.S dhe S.S me qëllim që t'ia mundësojnë R.Z të përfitojë në mënyrë të kundërligjshme subvencion në vlerë 93,400.00€, në atë mënyrë që, derisa i pandehuri R.Z në emër të biznesit "...” me datë 07.08.2020 aplikon për Bujqësi organike-bimë mjekësore dhe aromatike, të pandehurit L.S dhe B.M duke e ditur se i pandehuri R.Z kishte aplikuar për subvencione me disa kultura të cilat nuk subvencionohen sipas programit për vitin 2020, nr.2349/2, datë 19.06.2020, zyrtarët e AZHB-së e ftojnë përfaqësuesen e "...”me datë 12.11.2020 dhe e njoftojnë se disa kultura nuk subvencionohen, e njëjta e njofton me këtë rast pronarin e biznesit R.Z se disa kultura nuk subvencionohen, atëherë R.Z kërkon nga i pandehuri B.B që të ushtrojë ndikim të papërshtatshëm te personat zyrtar, pastaj i pandehuri B.B arrin marrëveshje me të pandehurit B.M dhe L.S për shumën e ryshfetit 14,000€ që në mënyrë të kundërligjshme të subvencionohen kulturat e "...”, pastaj procedohen për pagesë Vendimi ref.AZHB.07/4/2-025416/2020, datë 18.11.2020, në vlerë 44,849.00€ dhe kur kryhet pagesa në fillim të muajit dhjetor 2020, i pandehuri B.B nga i pandehuri R.Z në zyrat e Institutit Bujqësorë në Pejë pranon një zarf me para në vlerë 7,000€, pastaj e fton të pandehurin B.M në zyrën e tij, nxjerrë një zarfe me para 7,000€, ku prej tyre 5,000€ ia dorëzon B.Mt, ndërsa 2,000€ i ndal për veti sipas marrëveshjes paraprake, pastaj i pandehuri B.M nga vlera prej 5,000€, për veti e ndal shumë 1,000€, ndërsa pas disa ditësh shumë prej 4,000€ ia dorëzon të pandehurit L.S në Prishtinë, ndërsa pjesa e dytë e ryshfetit në shumë 7,000€, mbetet pa u realizuar, sepse për shkak të hetimeve u pezullua Vendimi Ref.AZHB07/4/2-002852/2021, datë 02.02.2021, në vlerë 48,551.00€,-

- me këtë ka kryer veprën penale Ushtrim i Ndikimit nga neni 424 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Andaj gjykata me aplikimin e neneve 7,17, 38, 39,40, 42,43, 44, 69, 79, 424 par 1 të KPRK-së dhe nenit 364, 449, 450 dhe 452 të KPPRK-së, të pandehurin e :

G J Y K O N

I pandehuri B.B, i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 1,000€ dhe dënim me burg prej 6 muaj, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit prej datës nga data 30.06.2021 deri me datë 30.09.2022, i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Në bazë të nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit B.B dënimit me burg prej 6 muaj t'i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 3,600€, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri i lartcekur që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej dyqind **(100) €**, ndërsa shumën prej njëqind **(100) €**, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. I pandehuri D.D, konfom nenit 364 par 1 të KPPRK-së,

ËSHTË FAJTOR

I pandehuri D.D , nga data 02.10.2020 deri me datë 02.02.2021, në Pejë, me qëllim që t'i mundësohet përfitimi i subvencionit nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë i jep ryshfet në mënyrë drejtpërdrejtë të pandehurit B.M, Inspektor Regjional në Zyrën Regjionale në Pejë dhe në mënyrë të tërthortë të pandehurit L.S, Drejtor i Pagesave Direkte, në atë mënyrë që, derisa i pandehuri D.D me datë 26.08.2020 aplikon në kërkesën nr.21/153301, pas një kohe kontaktohet nga zyrtar të AZHB-së kinse dokumentacioni nuk është në rregull dhe mund të futet në listën e zezë, pastaj i pandehuri D.D duke menduar se mund t'i humb subvencionet arrin marrëveshje me të pandehurin B.M dhe L.S për dhënien e ryshfet në vlerë 3,600€, pastaj me datë 03.10.2020, i pandehuri B.M takohet me të pandehurin D.D në fshatin R tek market "...” në P dhe i merr ryshfet pjesën e parë në vlerë 2,000€, dhe të njëjtat me datë 05.10.2020 ia dorëzon të pandehurit L.S në vlerë 2,000€, në zyrën e tij, në objektin e AZHB-së në Prishtinë, pastaj procedohet për pagesë Vendimi ref.AZHB.07/04/2-0069802020, i datës 20.10.2020, ndërsa kur procedohet Vendimi ref.AZHB.07/4/2-002826/2021, dt.02.02.2021 për pjesën e dytë i pandehuri B.M në fillim të muajit shkurt 2021 takohet me të pandehurin D.D në rrugën transit për P te marketi "...” dhe merr ryshfet 1,600€, pastaj shumën 600€ i ndalë për vete, ndërsa pas disa ditësh shumën 1,000€ ia dorëzon të pandehurit L.S në Prishtinë në kafiterit afër Gjykatës Kushtetuese,-

- Me këtë ka kryer veprën penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Andaj gjykata me aplikimin e neneve 7,17, 38, 39,40, 42,43, 44, 69, 79, 422 par 1 të KPRK-së dhe nenit 364, 449, 450 dhe 452 të KPPRK-së, të pandehurin e :

G J Y K O N

Të pandehurin D.D, i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 1,000€ dhe dënim me burg prej 6 muaj, në të cilin vendim llogaritet edhe koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak prej datës nga data 30.06.2022 deri me datë 30.07.2022, i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Në bazë të nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit D.D, dënimi me burg prej 6 muaj t'i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 4000 €, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri i lartcekur që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej dyqind **(100) €**, ndërsa shumën prej njëqind **(100) €**, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV. I pandehuri R.Z, konfom nenit 364 par 1 të KPPRK-së,

ËSHTË FAJTOR

I.

I pandehuri R.Z, nga data 01.11.2020 deri me 10.02.2020, në fshatin N, komuna P, me qëllim të përfitimit të subvencionit në mënyrë të kundërligjshëm i jep ryshfet në mënyrë drejtpërdrejtë të pandehurit B.M, Inspektor Regjional në Zyrën Regjionale në Pejë dhe në mënyrë të tërthortë të pandehurit L.S, Drejtor i Pagesave Direkte që të veprojnë në kundërshtim me detyrat zyrtare, në atë mënyrë që, paraprakisht i pandehuri B.M dhe R.Z pajtohen të aplikojnë me të dhëna të pasakta duke shtuar numrin e krerëve në blegtori dhe i pandehuri R.Z duke përdorur të dhënat personale të A.Z me rastin e aplikimit me datë 24.08.2020 paraqet rrejtshëm gjendjen faktike dhe në bazë të këtij deklarimi i lëshohet Vendimi ref.AZHB.07/4/2-027435/2020, dt.23.11.2020 dhe ref.AZHB.07/4/2-004798/2021, dt.02.02.2021 duke përfituar subvencion në vlerë 12,000€, dhe sipas marrëveshjes i pandehuri R.Z takohet me të pandehurin B.M në fshatin N dhe i dorëzon ryshfet në vlerë 3,000€, pastaj i pandehuri B.M nga kjo shumë 1,000€ i ndal për veti, ndërsa 2,000€ pas disa ditësh ia dorëzon të pandehurit L.S në kafiterin “...” në Prishtinë,-

- me këtë ka kryer veprën penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

II.

I pandehuri R.Z, me datë 24.08.2020, në fshatin N, Komunën e ..., me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme ka bërë mashtrim me subvencione duke paraqitur të dhëna të pa sakta në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, në atë mënyrë që, me datë 24.08.2020 në zyrat e komunës së Istogut duke përdorur të dhënat personale të A.Z plotëson formularin për aplikim nr.10/147438 për 93 krerë dele, mirëpo më vonë në bashkëpunim me Inspektorin B.M ndryshojnë të dhënat e krerëve të deleve, pasi që arrijnë të ndërhyjnë në Vërtetimin e veterinarit me nr.ref 384/2020, në atë mënyrë që nga numri 96 i krerëve të deleve i shtojnë numrin e krerëve të deleve në 493 duke i paraqitur kinse posedon 400 krerë dele

mbarështim dhe në bazë të këtij deklarami procedohet për pagesa direkte nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë Vendimi ref.AZHB.07/4/2-027435/2020, dt.23.11.2020 dhe Vendimi ref.AZHB.07/4/2-004798/2021, dt.02.02.2021 duke përfituar subvencion në mënyrë të kundërligjshme në vlerë 12,000.00€,-

- me këtë ka kryer veprën penale Mashtrim me Subvencione nga neni 324 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Andaj gjykata me aplikimin e neneve 7,17, 38, 39,40, 42,43, 44, 46, 59, 69, 79, 422 par 2, neni 324 par 1 të KPRK-së dhe nenit 364, 449, 450 dhe 452 të KPPRK-së, të pandehurin e :

G J Y K O N

Të pandehurin R.Z, për veprën penale Dhënie Ryshfeti, i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 1,000€ dhe dënim me burg prej 6 muaj, në të cilin vendim llogaritet edhe koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak prej datës nga data 30.06.2022 deri me datë 30.07.2022, i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Në bazë të nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit R.Z, dënimi me burg prej 6 muaj t'i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 4000 €, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të pandehurin R.Z, për veprën penale Mashtrim me Subvencione nga neni 324 par. 1 të KPRK-së, i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 5,000€, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimin me gjobë i pandehuri R.Z, nuk dëshirojnë ta paguajnë ose nuk mundën ta paguajnë gjykata bazuar në nenin 46 të KPK-së, dënimin me gjobë mund t ia zëvendësojë në dënim me burgim.

Ne vështrim të nenit 59 par 2 nën par 2.2, të KPRK-së, të pandehurit i cakton;

DËNIMIN PLOTËSUES

Në mbështetje të nenit 61 par 1 të KPRK-së, obligohet i pandehuri R.Z, që të bëjë kompensimin e dëmit të shkaktuar buxhetit të Republikës së Kosovës- në vlerë prej 12.000, 00 €.

Obligohet i pandehuri i lartcekur që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej dyqind (100) €, ndërsa shumën prej njëqind (100) €, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- V. I pandehuri S.B, konfom nenit 364 par 1 të KPPRK-së,

ËSHTË FAJTOR

I pandehuri S.B, me datë 13.12.2020, në ora 11:00, në restorantin në piken e derivateve “...” në ... në Prishtinë, me qëllim të përfitimit të subvencionit nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë i jep ryshfet të pandehurit L.S, Drejtor i Pagesave Direkte dhe të pandehurit B.M, Inspektor Regjional në regjionin e Pejës, ashtu që derisa i pandehuri S.B kishte aplikuar me kërkesën nr.21/153627 datë 27.08.2020 për subvencionim, pas një kohe kontaktohet nga zyrtar të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë kinse dokumentacioni nuk është në rregull dhe mund të futet në listën e zezë, pastaj i pandehuri S.B duke menduar se mund t'i humb subvencionet kontakton me të pandehurin B.M dhe në bashkëpunim me të pandehurin L.S i kërkojnë ryshfet në vlerë 1,600€, pastaj procedohet vendimi për pagesë në vlerë 22,666.60€, pastaj sipas marrëveshjes i pandehuri S.B dhe i pandehurin B.M takohen me të pandehurin L.S me datë 13/12/2020, në ora 11:00, në restorantin te pika e derivateve “...” në ... në Prishtinë dhe i pandehuri S.B i jep të pandehurit B.M shumën 1,600€, ku i pandehuri B.M shumën 300€ i ndal për veti, ndërsa të pandehurit L.S ia dorëzon shumë 1,300€ në veturën e tij në prani të pandehurit S.B,-

- me këtë ka kryer veprën penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Andaj gjykata me aplikimin e neneve 7,17, 38, 39,40, 42,43, 44, 69, 79, 422 par 1 të KPRK-së dhe nenit 364, 449, 450 dhe 452 të KPPRK-së, të pandehurin e :

G J Y K O N

Të pandehurin S.B i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 1,000€ dhe dënim me burg prej 6 muaj, në të cilin vendim llogaritet edhe koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak prej datës nga data 30.06.2022 deri me datë 30.07.2022, i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Në bazë të nenit 44 par.1 dhe nenit 79 par.4 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit S.B dënimi me burg prej 6 muaj t'i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 4000 €, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri i lartcekur që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej dyqind (100) €, ndërsa shumën prej njëqind (100) €, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimin, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

VI. I pandehuri P.K konfom nenit 364 par 1 të KPPRK-së,

ËSHTË FAJTOR

I pandehuri P.K, në muajin dhjetor 2020, në P dhe në I, me qëllim të përfitimit i jep ryshfet të pandehurit L.S, Drejtor i Pagesave Direkte në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë përmes të pandehurin B.M, Inspektor Regjional në regjionin e Pejës, në atë mënyrë që, i pandehuri P.K me të dhënat e birit të tij L.K aplikon për subvencione sipas kërkesës nr.21/132676 të datës 27.08.2020, por nuk i plotësonte kushtet për subvencionim dhe me datë 08.10.2020 vendoset në listën e zezë, pastaj i pandehuri B.M takohet me të pandehurin P.K në restorant “...” në dalje të Pejës dhe pranon ryshfetin në shumën 400€, pastaj pas disa ditësh këto para ia dorëzon të pandehurit L.S me datë 13.12.2020, në ora 11:00, në restorant te pika e derivateve “...” në ... në Prishtinë, pastaj me datë 15.12.2020 hiqet nga lista e zezë nga i pandehuri B.N në mënyrë të kundërligjshme në kundërshtim me raportin e komisionit në teren dhe në kundërshtim me nenin 26 të Udhëzimit Administrativë nr.03/2020,-

- me këtë ka kryer veprën penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata me aplikimin e neneve 7,17, 38, 39,40, 42,43, 44, 69, 79, 422 par 1 të KPRK-së dhe nenit 364, 449, 450 dhe 452 të KPPRK-së, të pandehurin e :

G J Y K O N

Të pandehurin P.K i shqipton , i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 1,000€ dhe dënim me burg prej 6 muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Në bazë të nenit 44 par.1 dhe nenit 79 par.4 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit P.K dënimi me burg prej 6 muaj t'i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 4000 €, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri i lartcekur që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej dyqind (100) €, ndërsa shumën prej njëqind (100) €, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar nga Avokatura shtetërore për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A R S Y E T I M

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, ka ngritur aktakuzën PPS.nr.105/22 të dt.22.12.2022, kundër të pandehurve L.S dhe B.M për shkak të veprës penale Marrje Ryshfeti nga neni 421 par.2 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK-së, i pandehuri S.S ka kryer veprat penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par. 2 të KPRK-së, i pandehuri B.N ka kryer veprat penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par. 1 të KPRK-së, i pandehuri B.B ka kryer veprën penale Ushtrim i Ndikimit nga neni 424 par. 1 të KPRK-së, të pandehurit G.M, R.Z, A.M, D.Dj, R.Z, H.M, kanë kryer veprën

penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 par. 2 KPRK-së, të pandehurit D.D, H.M, S.B, P.K kanë kryer veprën penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 par. 1 KPRK-së, të pandehurit G.M, R.Z, A.M, D.D, kanë kryer veprën penale Mashtrim me Subvencione nga neni 324 par. 1 lidhur me par 3 të KPRK-së, të pandehurit R.Z dhe H.M kanë kryer veprën penale Mashtrim me Subvencione nga neni 324 par. 1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, PPS.nr.105/22 të dt.22.12.2022, e që aktakuzës ia ka bashkangjitur edhe marrëveshje me pranimin e fajësisë PPS.nr.105/22 datë 16.12.2022, për të pandehurin B.M, dhe marrëveshje me pranimin e fajësisë PPS.nr.105/22 datë 20.12.2022, për të pandehurin B.B.

Gjykata, në kuptim të nenit 241 par.3 të KPPK-së, në seancën e shqyrtimit fillestar i mbajtur me datë 13.03.2023, i ka udhëzuar të akuzuarit për të drejtat e tyre ligjore dhe pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit Special, dhe në pika përmbledhëse elaboroi marrëveshje me pranimin e fajësisë PPS.nr.105/22 datë 16.12.2022, për të pandehurin B.M, dhe marrëveshje me pranimin e fajësisë PPS.nr.105/22 datë 20.12.2022, për të pandehurin B.B, duke deklaruar se mbetet në tërësi pranë marrëveshjes për pranimin e fajësisë, se me të pandehurit B.M dhe B.B dhe mbrojtësit e tyre janë pajtuar për të gjitha pikat e aktakuzës, për dënimin e rekomanduar, se të pandehurit B.M dhe B.B me vullnet të plotë, me vetëdije të plotë dhe pa kurrfarë trysnie se cili veç e veç e ka pranuar fajësinë e duke qenë i vetëdijshëm për pasojat dhe benefitet për pranimin e fajësisë, të cilin pranim e kanë bëri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre dhe kërkoi nga gjykata që pasi ta çmojë marrëveshjet dhe ta shqyrtojë e njëjtat ti pranohen. Andaj gjykata i ka udhëzuar të njëjtit në vështrimin të nenit 242, mbi të drejtën e deklaramit ose jo të pranimit të fajësisë. Të pandehurit B.M dhe B.B se cili veç e veç deklararon se mbetem në tersi pranë marrëveshjes së arritur në prokurori, të pandehurit D.D, S.B, P.K, se cili veç e veç deklararon se e pranojmë fajësinë për veprën penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 par. 1 KPRK-së, i pandehuri R.Z deklararon se e pranoj fajësinë për veprën penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 par. 2 KPRK-së, dhe për veprën penale Mashtrim me Subvencione nga neni 324 par. 1 të KPRK-së, ndërsa të pandehurit G.M, A.M, D.D, H.M se cili veç e veç deklararon se e pranojmë fajësinë për veprën penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 par. 2 KPRK-së, ndërsa të pandehurit G.M, A.M, D.D, H.M se cili veç e veç deklararon se nuk e pranojmë fajësinë për veprën penale Mashtrim me Subvencione nga neni 324 par. 1 lidhur me par 3 të KPRK-së, ndërsa të pandehurit L.S, S.S, B.N, R.Z dhe H.M se cili veç e veç deklararon se nuk e pranojmë fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohen.

Sipas Aktvendimit të Gjykatës Themelor në Prishtinë-Departamentit Special, PS.nr.55/2022, me datë 13.03.2023, pas marrjes së propozimeve dhe mendimit të palëve në procedurë, konform nenit 35 par. 1 dhe par. 2 veçohet procedura penale ndaj të pandehurit B.M, B.B, D.D, S.B, P.K dhe R.Z, për arsyeje të efikasitetit të procedurës të kësaj çështje penale.

Mbrojtësja e të pandehurit B.M av. M.B në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e kanë pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe deklaratën, qëndrojmë pranë të njëjtave, fillimisht i mbrojturi imë është konsultuar me kolegët e mi paraprak për natyrën, pasojat si dhe benefitet e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, po ashtu është njoftuar edhe nga ana e ime, qëndrojmë pranë kësaj marrëveshje dhe e lusim gjykatën të njëjtën marrëveshje ta aprovojë.

I pandehuri B.M në seancën e shqyrtimit fillestar deklararon se e kam kuptuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë. I kam kuptuar të drejtat e mia, jam i vetëdijshëm çfarë kam pranuar, mbetem pranë marrëveshjes së arritur. Paraprakisht jam konsultuar mjaftueshëm me mbrojtësin tim dhe jam pajtuar me të gjitha kushtet e marrëveshjes, kërkoj shumë falje.

Mbrojtësi i të pandehurit B.B av.H.S në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e kanë pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe deklaratën, qëndrojmë pranë të njëjtave, i mbrojturi imë është konsultuar mjaftueshëm me mua për natyrën, pasojat si dhe benefitet e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, qëndrojmë pranë kësaj marrëveshje dhe e lusim gjykatën të njëjtën marrëveshje ta aprovojë.

I pandehuri B.B në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se i kam kuptuar të drejtat e mia, jam i vetëdijshëm çfarë kam pranuar, mbetem pranë marrëveshjes së arritur. Paraprakisht jam konsultuar mjaftueshëm me mbrojtësin tim dhe jam pajtuar me të gjitha kushtet e marrëveshjes.

Mbrojtësi i të pandehurit D.D, av,F.B në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se i mbrojturi im D.D qysh nga fillimi e ka pranuar fajësinë për veprën penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 par. 1 KPRK-së, i njëjti është njoftuar për benefitet e fajësisë dhe jemi konsultuar mjaftueshëm, dhe kërkoj nga gjykata që të pranohet pranimi i fajësisë dhe të veçohet procedura penale ndaj tij.

I pandehuri D.D në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e kam kuptuar dispozitivin e aktakuzës dhe nuk kam nevojë për sqarime shtesë, deklarohet se e pranoj fajësinë për veprën penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 par. 1 KPRK-së.

Mbrojtësi i të pandehurit R.Z av. A.S në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi e mbështesim në tërësi pranimin fajësisë nga ana e të mbrojturit tim, pranimin e fajësisë e ka bërë pas konsultimit me mua si mbrojtës, është njoftuar për të drejtat dhe benefitet e pranimit të fajësisë, gjithashtu propozojmë gjykatës që të pranohet pranimi i fajësisë dhe të veçohet procedura ndaj të mbrojturit tim.

I pandehuri R.Z në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e kam kuptuar aktakuzën, nuk kam nevojë për sqarime shtesë deklarohem e pranoj fajësinë për dy veprat penale me të cilat ngarkohem Dhënie Ryshfeti nga neni 422 par. 2 KPRK-së, dhe veprën penale Mashtrim në subvencione nga neni 324 par. 1 të KPRK-së.

Mbrojtësi i të akuzuarit S.B av.A.Rr në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e mbështesim deklarinimin mbi pranimin fajësisë nga ana e të mbrojturit tim, pranimin e fajësisë e bënë pas konsultimit të mjaftueshëm me mua si mbrojtës, duke ia sqaruar benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe i propozoj gjykatës që të aprovon pranimin e fajësisë dhe të veçohet procedura ndaj të mbrojturit tim.

I pandehuri S.B në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e kam kuptuar aktakuzën, nuk kam nevojë për sqarime shtesë deklarohem se e pranoj fajësinë për veprën penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 par. 1 KPRK-së.

Mbrojtësi i të pandehurit P.K, av.N.Th në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e dëgjuat deklaratën e të pandehurit, besoi se deklarata ka qenë mjaft e çart, të njëjtën deklaratë e ka dhanë në prokurori dhe hetuesi, dhe kërkoj nga gjykata që ta aprovon pranimin e fajësisë dhe të veçohet procedura penale ndaj tij.

I pandehuri P.K në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e kam kuptuar aktakuzën, nuk kam nevojë për sqarime shtesë deklarohem se pas konsultimit me mbrojtësin tim e pranoj fajësinë për veprën penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 par. 1 KPRK-së, dhe shton se në fillim nuk e kam ditur se këto veprime përmbajnë vepër penale, por me ka njoftuar mbrojtësi imë.

Gjykata gjatë shqyrtimit të pranimit apo mospranimit të marrëveshjeve për pranimin e fajësisë, pas dëgjimit të prokurorit special, të pandehurve B.M dhe B.B dhe mbrojtësit të tyre, e komfor nenit 230 par 17 të KPPK-së, përcaktoi se të pandehurit B.M dhe B.B në tërësi e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të pandehurit e lartcekur, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre dhe se nuk ka qenë të detyruar ose shtrënguar në asnjë mënyrë që ta pranojë fajësinë, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat materiale të rastit konkret, të cilat paraqiten në aktakuzë dhe nuk ekziston asnjë nga rrethanat e paraqitura në nenin 248 par. 1 dhe 2 të këtij Kodi.

Gjykata pas marrjes së mendimit të prokurorit special, mbrojtësve dhe të pandehurve B.M dhe B.B dhe pasi që është bindur se janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara nga neni 230 par 17 të KPPRK-së, komfor nenit 230 par 20 të KPPRK-së, me Aktvendim pranoi Marrëveshjet për pranimin e fajësisë PPS.nr.105/22 datë 16.12.2022, për të pandehurin B.M, dhe marrëveshje me pranimin e fajësisë PPS.nr.105/22 datë 20.12.2022, për të pandehurin B.B, të lidhur ndërmjet Kryeprokurorit të PSRK dhe Prokurorit Special në njërën anë si dhe të pandehurve B.M dhe B.B dhe mbrojtësit në anën tjetër dhe urdhëroi që Marrëveshjet e lartcekura të vendosen në shkresat e lëndës së kësaj gjykate, e që palët në procedurë janë pajtuar me pranimin e marrëveshjes se pranuar nga gjykata pa asnjë vërejtje.

Nga Marrëveshja për pranimin e fajësisë dhe deklaratat e prokurorit special, të pandehurit B.M dhe mbrojtësit të tij, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha elementet qenësore subjektive dhe objektive të veprës penale Marrje Ryshfeti nga neni 421 par.2 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK-së.

Nga Marrëveshja për pranimin e fajësisë dhe deklaratat e prokurorit special, të pandehurit B.B dhe mbrojtësit të tij, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha elementet qenësore subjektive dhe objektive të veprës penale Ushtrim i Ndikimit nga neni 424 par. 1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit për të pandehurit B.M dhe B.B, e të rekomanduar në Marrëveshjet e pranuar nga gjykata, e njëjta mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 69 të KPRK-së, ku si rrethana lehtësuese mori sjelljen e tyre korrekte në gjykatë gjatë shqyrtimit, pranimin e fajësisë, pendimin e thellë për veprat e kryera penale, sinqeritetin e tyre deklarues, e të gjitha këto të përfshira në marrëveshjet për pranimin e fajësisë, në të cilën janë dakorduar për vendimin mbi dënimin dhe lartësinë e tij, e duke pasur parasysh se gjykata i pranoi Marrëveshjet për pranimin e fajësisë, andaj edhe të pandehurve B.M dhe B.B, ju shqiptoi dënimin si në dispozitiva e këtij aktgjykimi, e në pajtim me nenin 38 të KPRK-së, duke qenë e bindur se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit si në dispozitiva e këtij aktgjykimi.

Gjykata, gjendjen faktike në raport me veprat penale të përshkruara në aktin akuzues dhe në dispozitivin e këtij aktgjykimi, i ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga të pandehurit D.D, S.B, P.K dhe R.Z, ku për shkak të pranimit të fajësisë, gjykata fare nuk i ka administruar provat e çështjes. Sipas detyrës zyrtare dhe konform nenit 251 të KPPRK, gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa-pranueshme, gjithashtu në tërësi ka vërtetuar se të pandehurit D.D, S.B, P.K dhe R.Z e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprat penale për të cilat akuzohen. Pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe në konsultë të plotë me

mbrojtësit e tyre, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat materiale të cilat janë parashtruar me aktin akuzues e për të cilat të pandehurit D.D, S.B, P.K dhe R.Z, kanë qenë të njoftuar me kohë me të gjitha provat materiale dhe të njëjtat nuk i kanë kundërshtuar, por kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohen. Gjykata, erdhi në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurve të lartcekur është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPRK, dhe të njëjtit edhe e ka aprovuar në pajtim me faktet e provat që përmban akti akuzues, ku në veprimet e të pandehurit D.D, S.B, P.K, tek secila prej tyre formohen të gjitha elementet e veprës penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 par. 1 KPRK-së, ku edhe te i pandehurit R.Z formohen të gjitha elementet e veprës penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 par. 2 KPRK-së, dhe të veprën penale Mashtrim me Subvencione nga neni 324 par. 1 të KPRK-së, për këtë gjykata të pandehurit e lartcekur i shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimet sikurse në dispozitiva të këtij aktgjykimi.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin, respektivisht shqiptimit të dënimit me burgim dhe me gjobë, gjykata në harmonim 69, 70 të KPRK, vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikimin në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, e ku si rrethana vendimtare të cilat kanë ndikuar në përcaktimi e dënimit janë: pranimi i fajësisë nga të pandehurit D.D, S.B, P.K dhe R.Z për veprat penale për të cilat akuzohen, pendimi i tyre i thellë për kryerjen e veprës penale, bashkëpunimi dhe sjellja e tyre korrekte me gjykatën, por gjithashtu edhe me organet e ndjekjes penale dhe atë që në fazat e hershme hetimore, ku një fakt të tillë e dëshmon edhe vet përfaqësuesi i organit të akuzës, si dhe është hera e parë që bien ndesh me ligjin, ku në bazë të të dhënave nuk rezulton se më herët kanë pasur të kaluar kriminale apo kanë kryer ndonjë vepër penale, gjithashtu i kanë premtuar gjykatës se në të ardhmen do të jenë më të kujdesshme, nuk do bien ndesh me ligjin dhe nuk do të përsërisin ndonjë vepër penale, çoftë e llojit të kësaj për të cilën janë shpallur fajtorë apo ndonjë vepër tjetër penale, andaj duke u bazuar në të gjitha këto që u elaboruan, gjykata të pandehurve të lartcekur iu shqiptoi sanksionin penal dhe detyrimin sikurse në dispozitiva të këtij aktgjykimi, duke konsideruar se i përgjigjen shkallës së përgjegjësisë penalo juridike të tyre dhe se me këtë sanksion dhe detyrim do të arrihet qëllimi preventiv i dënimit, që në të ardhmen të pandehurit e lartcekur të përmbahen nga veprimet e tilla dhe se të integrohen në shoqëri.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimet e shqiptuar si në dispozitiva të këtij aktgjykimi janë në proporcion me peshën e veprave penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 69 të KPRK-së, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryesve, si dhe do të ndikojë te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale (paushallin gjyqësor), është marrë komfor neneve 449, 450 dhe 452 të KPPRK, pasi që gjykata në këtë çështje penale ka marrë aktgjykim dënues.

Vendimi mbi kompensimin e viktimave të krimit, gjykata e mori komfor nenit 36 par.3 nënpar.3.3 të Ligjit për Kompensimin e viktimave të krimit (Ligji Nr.08/L-109).

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të nenit 364 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiva të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI SPECIAL
PS.nr.10/2023, Datë 07 prill 2023**

Zyrtar ligjor,
Rilinda Kadriu

Kryetarja e trupit gjykues – Gjyqtarja
Violeta Namani-Hajra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 30 ditëve nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.